

# Newspaper on the Rights of Persons with Disabilities of Kosovo



e-mail: [newspwd@yahoo.com](mailto:newspwd@yahoo.com)

010

Revista e cila merret me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara



Iniciatore për fillimin e botimit të kësaj gazete është Zyra Amerikane në Prishtinë.

"Ky projekt u financua përmes grantit të zyrës së SHBA-ve në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo mendoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."



"Ky numër është financuar nga granti i ndarë nga Fondi për Mbështetjen e Mediave Minoritare, Multietnike dhe të Grupeve Tjera të Pafavorizuara. Këtë fond e ka themeluar Qeveria e Kosovës."

Mirë se erdhët në botën tonë

Kjo gazetë joprofitabile botohet në pesë gjuhë: si shtojcë në gjuhën shqipe distribuohet përmes të përditshmes (Koha Ditore), në gjuhën boshnjake përmes (Alem), në serbishte (Jedinstvo) dhe gjuhës turke (Jeni Donem). Në këto gjuhë dhe versionin anglisht mund ta lexoni edhe përmes website [www.lpkosova.com](http://www.lpkosova.com) Bashkpunëtoare vullnetare e redaksisë Diana Toska

## SHEFE I MISIONIT TË ZYRËS SË SHBA-VE

# JU I TOLERONI DALLIMET - NE DUHET TË MËSOJME NGA JU!

Më vjen mirë që më keni ftuar për të kontribuar për revistën tuaj. Ju dhe grupi juaj me të vërtetë jeni duke kontribuar për të siguruar kualitet më të mirë të jetës për njerëzit me nevoja të veçanta. Duke

lëvizur drejt integritimeve europiane, shoqëria e Kosovës duhet të bëjë hapa të mëtejme për të siguruar që mundësitë e barabarta janë në dispozicion për të gjithë.

Bashkësia ndërkombëtare është duke punuar me kosovarët për të siguruar që toleranca të jetë standard. Këtu në Kosovë, koncepti i tolerancës zakonisht

përdoret në kontekstin e marrëdhënieve etnike por toleranca ka të bëjë me të gjitha dallimet mes njerëzve. Gjersa punojmë së bashku për të ndërtuar një shoqëri demokratike në Kosovë e cila e çmon llojllojshmërinë e shumë komuniteteve të saj, ne asnjëherë nuk duhet të harrojmë se shoqëria jonë poashtu përfshinë edhe ata persona aftësitë e të cilëve mund të jenë ndryshe, nevojat e të cilëve mund të jenë ndryshe, dhe kontributi i të cilëve në shoqëri mund të jetë ndryshe.

Është vërejtur se marrëdhëniet ndëretnike në komunitetin e personave me aftësi të kufizuara janë të forta. Përmes përvojave tuaja ju keni mësuar që ti toleroni dallimet dhe të çmoni çdo person ashtu siç është dhe në bazë të asaj që ai/a mund t'i ofrojë shoqërisë, e jo t'i 'etiketoni' apo në ndonjë mënyrë t'i vëni ata në kategori që i izolon ata nga rrjedhat e përgjithshme. Në këtë aspekt ne kemi shumë për të mësuar nga ju.

Ne në SHBA këtë temë e marrim shumë seriozisht. Ngjarjet në pjesën e dytë të shekullit 20, sidomos

me fillimin e lëvizjeve për të drejtat civile dhe të drejtat e grave, i kanë ndihmuar opinionit dhe ligjvënësve tanë që të kuptojnë se të gjithë qytetarët tanë kanë të drejtë të marrin pjesë në shoqërinë amerikane, dhe se është në përgjegjësinë tonë që t'i japim çdo individ mundësinë për të marrë pjesë. Gjersa kjo mënyrë e edukimit publik është një projekt në vazhdim e sipër, kontributi i të gjitha pakicave për shoqërinë e SHBA-ve janë aq mirë të njohura tani sa që është vështirë të besohet se ndonjëherë kjo ka qenë ndryshe.

Në emër të Zyrës së SHBA-ve dhe popullit amerikan, ju dëshiroj sukses në ngritjen e vetëdijes në Kosovë për çështjet me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara, këtu dhe çdo ditë, dhe në vetëdijësimin e shoqërisë së gjërë kosovare për nevojat e veçanta që ju i keni dhe për kontributin që ju mund ta jepni.

Sinqerisht,  
Tina Kaidanow



Znj. TINA S. KAIDANOW  
SHEFE E MISIONIT

## KONVENTE E RE - EPOKE E RE

U arit një hap historic dhe Ad Hoc Komiteti miratoi Konventën mbi të drejtën e personave me aftësi të kufizuara dhe protokolin opcional.

Në mbledhjen e Ad Hoc Komitetit të KB në Njujork, morrën pjesë delegacione nga 120 shtete anëtare të KB, përfaqësues të agjensioneve dhe institucioneve si dhe mbi 800 përfaqësues të OJQ-ve nga mbarë bota. Pas 5 viteve biseda intensive, u arrit pajtimi për marveshje të Re mbi mbrojtjen e të drejtave të 650 milion personave me aftësi të kufizuara ose të 10 % të popullsisë së planetit. U miratua Konventa e Re mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Sekretari gjeneral i KB, Kofi Annan pasi përshëndeti të pranishmit konstatoi se, kjo konventë do të shënoj fillimin e një epoke të re me të cilën personat me aftësi të kufizuara do të kenë të drejta dhe privilegje sikurse të gjithë

të tjerët.

"Kjo është një ditë e madhe për KB dhe personat me aftësi të kufizuara. Kjo Konventë do të ndryshojë jetën e miliona njerëzve" theksoi Ambasadori i Zelandës së Re z Don McKay.

Përfaqësuesja e Little People of Kosova, Hilmnijeta Apuk, ndër të tjera kërkoi vëmendje më të përqëndruar ndaj vajzave dhe grave ngase në praktikë, sipas saj më së shpeshti të drejtat e tyre diskriminohen. Apuk insistoi në kujdes të posaçëm ndaj intereseve të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Little People of Kosova si anëtare e Ad Hoc Komitetit të KB morri pjesë aktive në sesionin e 8 të këtij Komiteti në Njujork, nga 14 deri më 25 shtatori, falë donatorëve nga Prishtina, Zyrës Amerikane, Sorosit dhe PTK.



Duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj Konvente në sferën e të drejtave të njeriut dhe kontributin e pranur publikisht të OJQ nga Kosova, mendoj se është aritur një sukses i madh në afirmimin dhe rolin e vendit tonë në planin ndërkombëtarë.

Të gjitha tekstet relevante lidhur me Konventën mund t'i gjeni në internet sajtin e KB: <http://www.un.org/esa/socdev/enable/>

MINI OLIMPIADA

RRJETI GLOBAL

KËSHILLI NACIONAL

TI RESPEKTOJMË DALLIMET

# KËSHILLI NACIONAL I KOSOVËS



Zyra e kryeministrit pasi ka inicuar dhe themeluar Këshillin Nacional për personat me aftësi të kufizuara më 3.07.2006, bëri edhe promovimin e këtij këshilli. Ai është i përbërë prej 16 anëtarëve dhe ata janë:

1. Lutfi Haziri Zëvendëskryeministër i Kosovës Kryesues i Këshillit
2. Habit Hajredini Drejtor i Zyrës për Qeverisje të mirë Zyra e Kryeministrit
3. Lulzim Leci zv. Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale anëtar
4. Bujar Kadriu - Shoqata e të verbërve dhe të pamur të dëmtuar të Kosovës-anëtar
5. Fevzi Berisha-zv.Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë-anëtar
6. Agim Vatovci-Shoqata e distrofisë muskulore-anëtar
7. Halit Ferizi, Handikos -anëtarë

8. Aziz Lila-zv.Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal-anëtar
9. Ramadan Gashi-Klubi "Dëshira"-anëtar
10. Fadil Kryeziu-zv.Ministër i Shëndetësisë
11. Sabrije Zeqaj, Handikos- anëtare
12. Blerim Baruti-zv.Ministër i Transportit dhe Postë Telekomunikacionit
13. Hilmnijeta Apuk-organizata Njerëzit e Vegjël të Kosovës
14. Faruk Kukaj,-anëtar
15. Saqir Hagjaj, OPFAKOS - anëtarë
16. Boban Stanković, Shoqata për persona me aftësi të kufizuara-anëtarë

Këshilli nacional duhet të takohet më së paku 4 herë në vit. Ai mund të thirret edhe me iniciativën e më shumë se gjysmës së antarëve ose me ftesë nga përfaqësuesi i zyrës së kryeministrit.



## SFIDË PËR TË VERBËRIT

Doli nga botimi numri i parë i gazetës me zë, "Sfida Jonë" në gjuhën shqipe dhe boshnjake, të cilën e përgaditi, shoqata e të verbërve nga Peja në bashkpunim me shkollën speciale për të verbër në Pejë, ndërkaq, donatore ishte Zyra e Kryeministrit.

Të interesuarit mund ta gjejnë këtë numër të gazetës në të gjitha zyrat rajonale të Shoqatës së të verbërve të Kosovës.

## KRYEMINISTRI PËRKRAH MEDIUMET E PAKICAVE

Zyra e kryeministrit ka mbështetur financiarisht mediumet e pakicave dhe ato multietnike. OJQ, Little People of Kosova për gazetën mujore "Newspaper on the Rights of Persons with Disabilities of Kosova" që trajton temat ekskluzivisht për personat me aftësi të kufizuara, e që botohet në tri gjuhë dhe si shtojcë shpërndahet përmes Kohës Ditore, ALEM dhe Jeni Donem, ka fituar dy grante. Grant nga Qeveria, ka fituar edhe revista tonike "Sfida jonë" Shoqata e të verbërve nga Peja. Kryeministri Çeku pasi ndau grantet, fituesve iu dëshiroi suksese dhe rezultate të reja në punë.



## SPORT PËR TË VERBËRIT

Kryetari i Federatës së të verbërve të Kosovës dhe koordinator i Shoqatës së të verbërve nga Peja, z. Daut Tishuki dhe drejtori i shkollës speciale për të verbër "Xheladin Deda" nga Peja, z. Ahmet Mahmutaj qëndruan në vizitë 10 ditëshe në Bruksel, në qershor të këtij viti. Përfaqësuesit kosovar patën takime tejet të frytshme dhe kërkuan që Federata e Sportit të Shoqatës së të verbërve të Kosovës të pranohet në Federatën e Sportit europian të të verbërve. Ky propozim zyrtarisht i u dorëzua në shqyrtim Komitetit Paraolimpik të Belgjikës, që përkrahet nga Gjermania dhe Holanda. Në parim u arit pëlqimi që në Pejë të organizohet një takim me karakter ndërkombtarë në të cilin do të licencoheshin arbitrit kosovar për sportet e të verbërve, si një ndër kushtet për pranim në Federatën e Sportit të të verbërve të Kosovës në Federatën Europiane të sportit. Delegacioni nga Kosova gjatë vizitës në Belgjikë ka vizituar shkollën speciale për të verbër dhe qytetin, Molje në Holandë i cili është i binjakëzuar me Pejë.

## MIRENJOHJE

Pjesëmarja e Kosovës në Ad Hok Komitetin e KB me rastin e miratimit të Konventës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, donuar nga:



## SUKSESE NË LËMIN E PUNËSIMIT

OJQ Hencipated and Disabled People of Kosova HDPK (OJQ Shoqata e personave me Hencicep dhe aftësi të kufizuara të Kosovës) me sukses ka arritur të punësoj 20 anëtarë të kësaj organizate dhe ta zbusë gjendjen ekonomike të familjeve të tyre.

Shfrytëzuan situatën dhe biseduam me z. Agim Vatovci, kryetar i OJQ HDPK që të na tregoj diç më shumë mbi këtë sukses kaç të madh. Si e aritët këtë rezultat?

-Fillimisht dua ta falenderoj Zyrën Amerikane në Prishtinë që na finanson që nga themelimi dhe kështu na mundësoi të arimë suksese të mëdha për antarët tonë. Në fillim organizuam për antarët tanë kurse të kompjutorit dhe mësim të gjuhës angleze, kjo mundësoi ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale. Pastaj jemi angazhuar tepër shumë dhe ia kemi arritë që ti punsojmë 20 antarë në sektorin privat po edhe në institucione shtetërore. Tani 9 persona punojnë në SHPK. Me këto punsime jo vetëm që kemi ndihmuar familjet e antarëve tanë, por atyre ua kemi kthyer dinjitetin njerëzor, ata sot po ndihen të dobishëm po i kontibujojnë shoqëris kosovare, por në anën tjetër duhet theksuar se me këto punësime kemi shkarkuar buxhetin shtetëror, ata më nuk kanë nevojë për ndihma sociale. Shpresoj shumë që në të ardhmen shteti do të ketë mirkuptim më të madh dhe kjo shtresë e shoqëris do ta gjej vendin e merituar gjatë punësimit, tha ndër të tjera z. Agim Vatovci.



Të përkujtojmë se e drejta për punë është një ndër të drejtat themelore të njeriut e paraparë në të gjitha dokumentet ndërkombëtare, e posaqërisht theksohet në Konventën mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, ku shtetet obligohen tua njohin të drejtën në punë personave me aftësi të kufizuara në bazë të parimit të barazisë me të tjerët.



Lexues të nderuar,

25 shtatori i këti viti do të shënohet me shkronja të arta në historikun e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Ad Hok Komiteti në këtë ditë të shejtë miratoi Konventën mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Kjo ishte një ditë e madhe për 650 milion persona në mbarë botën ose 10% në mbarë planetën. Kësaj Konvente i aplaudoi mbarë bota e civilizuar, ndërsa miratimin e saj e pritën në këmbë, delegacionet e 120 shteteve anëtare të KB, përfaqësues të agjensive dhe institucioneve të OKB, institute

nacionale për të drejtat e njeriut dhe mbi 800 përfaqësues të OJQ-ve nga bota, në mesin e të cilëve ishte edhe Kosova.

Marrëveshja e Re mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut me aftësi të kufizuara, përkatësisht, Konventa shënon një përparim historik. Tani i mbetet çdo shteti veç e veç të punojë, ta sensibilizojë, ta implementojë dhe ti njoftojë të gjitha institucionet relevante shtetërore, e posaqërisht organizatat që merren me këto të drejta për rëndësin e saj dhe humanitetin njerzoz që sjellë ajo në shekullin që po e jetojmë.

Mendojmë që gazeta jonë po e luan një rëndësi të veçantë në njoftimin dhe sensibilizimin e opinionit, prandaj mbesim me shpresë që ajo do të gjej mbështetje të reja në këtë mission të shejtë.

E juaja,  
Hilmi Nijeta Apuk

## **POLONIA - NDEROHET ME ÇMIMIN - "FRANKLIN D. RUZVELT - FDR"**

Më 19.shtator të këti viti ( New York): KB i ndanë Polonisë çmimin ndërkombëtarë - Franklin Delano Ruzvelt ( FDR) për kyçjen e suksesshme të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. Presidenti, Leh Kaznjicki (Lech Kaczynski) **pasi pranoi shpërblimin në ndërtesën e KB në Nju Jork**, theksoi se përpjekjet e shtetit të tij janë të orientuara kah kyçja e lirë dhe mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, ndërkohë që sipas tij, ato garantohen me kushtetutë.



Nga e majta : Presidenti Polak Kaznjecki, Sekretari gjeneral i KB, Kofi Annan dhe mbesa e Franklin Ruzveltit , Anna Eleanor Roosevelt

Presidenti Kaznjecki, tha se Polonia do ta miratojë Konventën e re që u miratua rishtaz në KB. Çmimi ndahet në kujtim të ish presidentit amerikan, Franklin Delano Ruzvela, i cili ishte i paralizuar në të dy këmbët si pasojë e polios.

## **RRJETI GLOBAL**

Më 27-28 shtator në Nju Jork u mbajtë Kuvendi gjeneral i RI rrjetit global të organizatave të shoqëris civile dhe agjensioneve qeveritare që promovojnë dhe implementojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara me çrastë, aplikacioni i OJQ Little People of Kosova u përkrah dhe iu mundësua antarësim në mesin e 82 vendeve. Ky rrjet merret me zhvillimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut të garantuara në Konventën mbi të drejtën e personave me aftësi të kufizuara.



## **MUNDËSI PA PARAGJYKIME**

# **ROOSEVELT - NGA KARROCA MPOSHTI KRIZAT BOTËRORE**

Pertsonaliteti qendror i shekullit 20 dhe Presidenti i 32 i SHBA-ve, Franklin D. Roosevelt, është presidenti i vetëm në botë i cili gadi për, tri mandate ( 1933 1945) nga karroca në Shtëpin e Bardhë, me sukses udhhoqi, popullin amerikan nëpër kriza të mëdha botërore, atë ekonomike dhe luftën e dytë botërore.

Presidenti Ruzvelt është njëri ndër autorët ideor për krijimin e KB dhe i cili fuqishëm ka besuar se ky organizëm do të avansoj statusin dhe të drejtat e pakicave në të gjithë botën. Ndërsa personat me aftësi të kufizuara, sipas tij, janë pakica e çdo shoqërie në botë.

Në tetorin e vitit 1995 me rastin e kremtimit të 50 vjetorit të krijimit të KB, "Instituti Franklin dhe Eleonora Ruzvelt" inicoi ndarjen e shpërblimit ndërkombtarë, " Franklin Delano Roosevelt " për kontribut të jashtzakonshëm në fushën e avansimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në nivelin global. Kjo nismë nxiti nevojën për krijimin e Konventës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, teksti punues i së cilës u miratua në gusht të këti viti në KB dhe u plotësua programi aksionar botëror (World Programme of Action). Ky Program i rekomandon shtetet, bashkësitë, organizatat, religjionet dhe njerëzit e vullnetit të mirë nga mbarë bota tu mundësojnë çasje të përgjithshme personave me aftësi të kufizuara për shkaqe ekonomike, humanitare e sociale.



## GJUEJTJE

Gjuajtja testohet në saktësinë, në fuqinë dhe koncentrimin e atletit. Ky sport është i hapur për atletët me aftësi të kufizuara, ( duke përfshirë dhe paralizën celebrale, spina bifidu, amputimet ....) dhe ndahet në tre klasa



funktionale. Garimi mund të jetë individual ose ekipor. Ndërsa garuesit mund të qëndrojnë në këmbë apo të ulur në karroca. Garuesit gjuajnë nga largësia në cakun e shënuar me dhjetë rrrathë. Trupi udhëheqës IPC Komiteti paraolimpik ndërkombëtar për gjuajtje përcjell rregullat e FITA, (Komiteti paraolimpik ndërkombëtar për gjuajtje për sportistët), por ka disa ndryshime të vogla në përputhshmëri me rregulloren e Komitetit Paraolimpik për gjuajtje. Aktualisht, 37 shtete garojnë në këtë sport dhe numri i tyre dita më ditë po shtohet. Ky sport zanafillën e ka nga Roma dhe ka filluar të aplikohet më vitin 1960.



## LUFTË ME SHPATA NË KARROCË

Kjo disiplinë e sportit paraolimpik ka filluar të zgjojë interesim edhe tek personat me aftësi të kufizuara. Karakteristike është se karrocet gjatë garimit janë të përforcuara për dyshe, mirëpo i mundësohet garuesit liria e lëvizjes me pjesën e sipërme të trupit. Në



këtë disiplinë mund të marrin pjesë sikur, burrat ashtu edhe gratë, me ekstremitete të amputuara, personat me paralizë celebrale dhe mund të garojnë individualisht dhe në mënyrë ekipore. Trup zyrtar udhëheqës është Komiteti ndërkombëtarë për luftë me shpata (IWFC). Ky sport është përfshirë në sportet Paraolimpike në vitin 1960 në Romë dhe tani më në këtë disiplinë janë të përfshira 24 shtete.



## BUKURIA E VALLËZIMIT NË KARROCË

Eleganca, stili dhe ritmi janë bukuritë që kërkohen dhe çojnë drejt një fitoreje të sigurtë. Vallëzimi sportiv në karrocë përfshinë, veç tjerash edhe personat me kurriz të lënduar. Vallëzuesit në karrocë mund të marrin pjesë në "combi"-stilin dhe të luajnë me partnerin, personin i cili qëndron në këmbë, ose në duet, dy persona në karrocë. Standardet e kësaj loje përfshijnë: valcerin, tangon, folkstrotin dhe stepin. Vallëzimet Latino-Amerikane përfshijnë, sambën, cha-cha-cha, ramba, paso. Garimi zhvillohet në formacione prej 4, 6 dhe 8 qifteve. Në vitin 1977 është mbajtur garimi i parë

ndërkombëtarë në vallëzimin në karrocë në Suedi. Pas disa viteve janë organizuar edhe disa manifestime me karakter rajonal e ndërkombëtarë, ndërkaq kampionati i parë botëror është mbajtur në Japoni më 1998 dhe prej atëherë ai është konsideruar si sport paraolimpik. Komiteti paraolimpik për vallëzim në karrocë (IPWDSC) përcjell rregullat e modifikuara të Federatës ndërkombëtare për vallëzim ( IDGSF). Vallëzimin në karrocë e aplikojnë atletët nga 19 shtete.



Në organizim të OJQ, Opfakos-it, që përfason dhe tubon prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, u mbajt mini olimpiada dyditore në të cilën garuan rinia me diagnoza të ndryshme. Ishin të pranishëm 577 persona prindër me fëmijë nga 27 komuna. Në garë morrën pjesë 156 garues me aftësi të kufizuara, në 8 disiplina të ndryshme: hendboll, basketboll, pikado, gjuetje, ringboll për të verbër, gara në karrocë, shah dhe lojra të pakufishme për fëmijë. Fituesit u shpërblyen me medalje për garim individual dhe ekipor. Takimi u mbajt në qershor në akademin Policore në Vushtri, ndërsa e donoi, SHPK dhe Departmenti për sport dhe rini nga Ministria e Sportit.

E drejta në sport dhe rekreim e personave me aftësi të kufizuara është një ndër të drejtat e parapara në Konventën në të cilën theksohet se shteti duhet tu ofrojë mundësi kësaj kategorie të personave të organizojnë, zhvillojnë dhe marrin pjesë në aktivitetet specifike sportive për personat me aftësi të kufizuara dhe në këtë kuadër të kenë çasje deri te objektet sportive. Kjo, Mini Olimpiadë ishte e një rëndësie të veçantë, sepse u dha mundësin fëmijëve me aftësi të kufizuara të kenë çasje të barabartë në lojë, rekreacion dhe aktivitete sportive.



## NJË VIZITË PUNE NË BRUKSEL

Në kuadër të proektit EDF, "Përkrahja e realizimit të ombrell organizatave dhe rrjetit të tyre në rajonin e CARDS", delegacionet që merren me çështjet e personave me aftësi të kufizuara nga Kosova, Bosnja e Hercegovina dhe Maqedonija, morrën pjesë në Bruksel nga 19-27 korriku në një tubim studiu.

Delegacionin pesantarësh nga Kosova e përbënin: Ramadan Gashi (shoqata e shurdhmemecëve) dhe përkthyesi I tij, Afrim Maliqi (Hendikos), Aziz Nishori (Opfakos), Mexhid Funiqi (shoqata e të verbërve).

Qëllimi i kësaj vizite ishte që pjesmarrësve tu sigurohet çasje në proceset e vendimmarrjes në kuadër të Këshillit të Europës, posaqërisht në sferën që ka të bëjë me çështjet e personave me aftësi të kufizuara, si dhe në procesin e stabilizimit dhe bashkangjtitjes, KE. Pjesmarësit u takuan me anëtarët e Parlamentit Evropian dhe zyrtarët e Komisionit Evropian.

**EDF organizoi një tubim informativ mbi funksionimin e institucioneve dhe lobimin. Delegatët takuan poashtu edhe përfaqësuesit e organizatave invalidore europiane me qëllim të këmbimit të përvojave.**



## KONVENTA DHE IMPLEMENTIMI PRAKTIK-SEMINAR MBI TË DREJTAT E NJERIUT

Në Nju Jork (SHBA) më 26 shtator të këtij viti u mbajt një Seminar në nivel global mbi implementimin e Konventës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në të cilën diskutuan: Don MacKay, Ambasador i Zelandës së Re dhe kryesues i Ad Hoc Komitetit të KB, Theresia Degener, profesore Universitare në Gjermani, përfaqësues qeveritar dhe lider të shoqëris civile nga mbarë bota, në mesin e të cilëve mori pjesë edhe përfaqësuesi nga NGO Little People of Kosova.

Seminarin e organizoi RI dhe USICD (U.S. International Council on Disabilities), ndërsa donator për pjesëmarrje të Little People of Kosova ishin Zyra Amerikane në Prishtinë, SOROS dhe PTK.

Seminari tuboi ekspertë mbi të drejtat e njeriut me aftësi të kufizuara nga mbarë bota dhe diskutoi se si këta persona, qeveritë dhe përfaqësuesit mund ti mbrojnë të drejtat nga kjo Konventë përmes zhvillimit të politikave dhe programeve që do ta përmirësonin statusin e këtij grupi të qytetarëve në botë.

Qëllimi i këtij seminari ishte implementimi i Konventës dhe efekti i tij praktik në ngritjen e vetëdijes mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, këmbimin e përvojave në nivel global dhe përforsimin e partneritetit në mes të qeverive dhe shoqëris civile.





## TI RESPEKTOJMË DALLIMET

Dita Ndërkombëtare e Gruas, 8 Marsi është kremtuar me focus të veçantë në të drejtat e grave me aftësi të kufizuara. Edhe sivjet kjo ditë u shënuar në Hotelin Grand të Prishtinës, ku morën pjesë më shumë se 120 gra dhe vajza me aftësi të kufizuara nga mbarë Kosova. U ndanë dhurata dhe broshura në temën : të drejtat e femrës nga konventa mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara nga e cila doli porosia, TI RESPEKTOJMË DALLIMET.

Përpjekjet në avansimin e të drejtave të grave me aftësi të kufizuara i kanë përkrahur me fjalimet e tyre edhe përfaqësuesi i Zyrës Amerikane në Prishtinë, z- Wendy Kolls, përfaqësuesi i OSBE së, Drejtori i Departamentit për të drejtat e njeriut, z- Henry McGoven, përfaqësuesi i PTK, z- Seremb Gjergji, përfaqësuesi i Zyres për Qeverisje të Mirë, z- Habit Hajredini, përfaqësuesi i FES-it, z- Besa Luzha dhe përfaqësuesi i UNMIK-ut, z- Maddalena Pezzoti. Poashtu tubimin e përshëndetën edhe përfaqësuesit OJQ-ve, e Programit Promotiv Vullnetar - DMD, z- Xhevat Islami, Fazile Bungu, Hiljmnijeta Apuk dhe të tjerë.



## TË DREJTAT TË GARANTOHEN ME KUSHTETUTË

Me iniciativë të lidereve nga Programi Promotiv Vullnetar DMD më 12 prill të këtij viti në Prishtinë u mbajt një takim mes liderëve të OJQ-ve nga mbarë Kosova, të cilat meren me çështjet e personave me aftësi të kufizuara, në temën " si ti qasemi qëllimeve të konventës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara". Liderët morrën vendim unanim që të ftohen të gjithë faktorët relevant ndërkombtarë në Kosovë, delegatët e Kuvendit të Kosovës, përfaqësues të shoqëris civile dhe sektorit privat dhe të gjithë së bashku të marrin qëndrim se si ti qasen qëllimeve të Konventës Ndërkombtare mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. U konstatua se jo vetëm që duhet të shihen mundësit por edhe këto të drejta duhet të implementohen në kushtetutën e Kosovës dhe të respektohen nga të gjithë.



## KUVENDI I DYTË I FËMIJËVE TË KOSOVËS



Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të fëmijut, 1 Qershori, u organizua për herë të dytë Kuvendi i Fëmijëve të Kosovës. 6 fëmijë me aftësi të kufizuara si ambassador të zgjedhur të fëmijëve nga mbarë Kosova, kanë dorëzuar letrat kredenciale, Presidentit të Kosovës z- Fatmiru Sejdiu . Pas pritjes së ngrohtë dhe mesazheve që pranoi presidenti nga fëmijët, ai organizoi një konferencë me gazetarë me çrast theksoi: Këta fëmijë do ta kenë mbështetjen e plotë të institucioneve të Kosovës.

Cilat ishin porositë e fëmijëve në letrat kredenciale që ja dorzuan presidentit: mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në arsim, zhvillimi i kapaciteteve të tyre, respektimi i interesit të fëmijëve, mbrojtja shëndetësore, e drejta në integritet, barazi në mes të djemve dhe vajzave, jodiskriminimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara.



Kjo ngjarje është pjesë e Programit Promotiv vullnetar - DMD.

## AUTOBUSI PAQES PER VIZITE NE SHQIPERI

Ministria për sport, kulturë e rini në shtator të këtij viti organizoi një vizitë kulturore në Shqipëri, për 27 persona me aftësi të kufizuara, përkatësisht për anëtarët e Opfakos-it, Hendikos-it, Hendikep Kosova, Shoqatën e shurdhmemecëve, Shoqatën e të verbërve dhe Shoqatën Little People of Kosova.

Autobusi Paqës nga Kosova përveç që vizitoi përmendoret kulturore nëpër Shqipëri realizoi një sërë takimesh me OJQ që merren me çështjet e personave me aftësi të kufizuara. Në këto takime miqësore u këmbyen përvoja dhe u panë mundësitë e bashkëpunimit rajonal.



# HUMANITETI NË VEPËR

Në Nekudim të Ferizait u organizua shëtitje një ditore dhe u shtrua drekë për 125 persona me aftësi të kufizuara. Me këtë rast u organizuan aktivitete të ndryshme sportive si në notim, futboll të vogël, pikado, shah dhe ping-pong.



Kjo shëtitje ishte një kënaqsi e vërtetë për këtë kategori qytetarësh të cilët mund të dalin nga shtëpitë dhe ta shijojnë bukurinë e jetës vetëm atëherë kur dikush dhe dikujt i kujtohet se përreth nesh ka nevojë edhe dikush që ti falet pak kujdes. Ky rekreacion sportiv dhe dalja e tyre nga shtëpia ishte një integrim i vërtetë i tyre në shoqëri. Këtë humanitet e organizoi me donimin e CDF, OJQ Hendifer nga Ferizai.

Rekreimi dhe integrimi janë të drejta themelore që duhet të gëzojnë personat me aftësi të kufizuara.

# KONVENTAT DUHET RESPEKTUAR

Gjashtë të rinjë ferizajas me aftësi të kufizuara pas mbarimit me sukses të shkollës fillore kanë hasur në pengesa dhe moskuptim nga disa zyrtarë, gjatë regjistrimit në shkollën e mesme. Mirëpo falë angazhimit dhe reagimit me kohë të OJQ Hendifer ky keqkuptim është tejkaluar dhe këta të rinjë do të ulen sëbashku me shokët e shoqet në bankat e shkollore. E drejta për tu arsimuar personat me aftësi të kufizuara është një ndër të drejtat themelore dhe parim që theksohet në Konventën mbi të drejtat e njeriut.

## ORTOPEDIA PRODHON DHE RIPARON KARROCA

OJQ Hendifer nga Ferizai hapi puntorin për prodhimin dhe riparimin e karrocave, si dhe mjeteve tjera ndihmëse ortopedike në kuadër të



projektit të Bankës Botërore. Poashtu, World Vision kësaj puntorie i siguroi një pjesë të makinave për punë.

Në hapjen solemne më 23. gusht morrën pjesë përveç, shumë të ftuarve edhe z. Dugagjin Etemi nga Komuna, z. Shpend Ahmeti nga Banka Botërore, Drejtoresha e World Vision,

z.Sharon Burton dhe Xhevat Islami menaxher i "Hendiferit" dhe

njëherit bartës i projektit.

Programi prodhues i punëtoris, Ortopedia Hendifer, është i vetmi në Kosovë i cili jo vetëm që do të prodhojë për nevojat e tregut, por prodhimet e saja do tua përshtatë nevojave specifike të çdo personi me aftësi të kufizuara.

"Shfrytëzoj rastin të apelojë që karrocet e vjetra të mos hidhen, por të sillen tek ne në riparim." porositi menaxheri, Xhevat Islami.

Për informata më të hollësishme mos hezitoni ta kontaktoni, Xhevat Islamin dhe Fazile Bungun në telefonat:

0290 21 374; **044 226 923**; email: [hendifer\\_f@yahoo.com](mailto:hendifer_f@yahoo.com)

Pritet një përkrahje nga Ministria e Shëndetësis për këtë punëtori, ngase sigurimi i mjeteve ortopedike dhe karrocave për persona me aftësi të kufizuara është në kompetenca të saj, ndërsa mobiliteti personal është një ndër të drejtat elementare të kësaj kategorie të qytetarëve të Kosovës.

## LUFTË KUNDËR IZOLIMIT

OJQ "Hendifer" nga Ferizai ka filluar zhvillimin e servis shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, parasëgjithash për personat e palëvizshëm e që jetojnë vetë. Në këtë project të donuar nga CDF zyra në Prishtinë, janë angazhuar 45 vullnetar nga shkollat e mesme që nga tri here në javë ti vizitojnë këta persona të palëvizshëm. Këta të rinj vullnetar hapin e të cilëve duhet ndjekur e mbarë rinia kosovare, jo vetëm që i vizitojnë dhe i shoqërojnë, por me kënaqësi iu ndihmojnë atyre duke iu mundësuar higjienë personale, ushtrime fiziatrike, blerjen e ushqimit, përgaditjen e ushqimit, turshis, pastrimin e shtëpis.



Në këtë aktivitet human të organizuar nga menaxherët, Islami dhe Bungu i cili ka filluar në muajin mars dhe do të zgjasë deri në dhjetor do të trajtohen dhe përkujdesen nga vullnetarët rreth, 50 persona me aftësi të kufizuara. Të trajtuarit ndihen mirë në shoqërin e kësaj rinie, duke shprehur falenderime publike tregojnë për momente tejet të ngrohta e humane nga çastet e kaluara bashkë. Bile disa prej tyre dëshmojnë se kanë patur plagë të hapura,(dekubite) në tërë trupin, por tani thonë se nuk janë vetëm dhe të haruar.

Këtë iniciativë të Hendiferit e ka përkrah qendra e medicinës familjare dhe ka vendosur që ta marrë nën përkujdes dhe shërim shtëpiak këtë kategori të qytetarëve.

Këto lloj aksionesh humanitare të OJQ-ve gjithherë kanë dëshmuar se janë të mirëseardhura e të mirëpritura, prandaj, ato duhet përkrahur dhe zgjëruar në mbarë vendin.

## REHABILITIM GJATË PUNËSIMIT

Më 12 shtator të këti viti, AgimVatovci, kryetar i OJQ Hencipped and Disabled People of Kosova HDPK dhe Veton Suroi, lider i partisë politike ORA mbajtën një konference me gazetarë në të cilën njoftuan të pranishmit me ligjin mbi rehabilitimin dhe përparësit që duhet të meren parasysh gjatë punësimit të personave me aftësi të kufizuara. Ky propozim është dhënë nga z. Vatovci dhe është procesuar në Kuvendin e Kosovës. Në këtë project propozim kërkohet që çdo organizatë qoftë private a shtetërore të obligohet të punësojë një përqindje të personave me aftësi të kufizuara në raport me numrin e të punësuarve që ka.



## Trening Centar Telekom Kosova PTK SHPRESË PËR PUNËSIM

Trajning qendra Telekom Kosova PTK mbajti një kurs kompjutori me emrin,ECDL ku aftësoi për punë me kompjutor 15 antarë të OJQ Hencipped and Disabled People of Kosova HDPK. Antarët që kaluan në këtë kurs janë: Vjollca Preka, Bahtishah Basha, Petrit Frroku, Lendita Basha, Mehmet Kastrati, Edita Basha, Valbona Sahiti, Ramize Basha, Ilir Berisha, Violeta Zefi, Agim Sahiti, Aferdita Rama, Ganimete Demolli, Rabije Ajeti i Bekim Rexhepi. z. Agim Vatovci, Kryetar i HDPK shpreson që faktorët relevant të shoqëris kosovare do ta përkrahin punësimin e tyre.

## NJOFTIM PËR SHOQËRIM




Klubi Dëshira - Clubhouse thëret të gjithë të interesuarit që kanë pengesa apo vështërsi

mentale të lajmërohen me qëllim të përfshirjes së tyre në aktivitetet ditore të këti klubi. Mund ta kontaktoni, z. Nusret Shillova në telefonin, 044 173 974, e-mail: [clubhousedeshira@hotmail.com](mailto:clubhousedeshira@hotmail.com) ose në adresën:rr. Haxhi Zeka n.55, ( te shkolla teknike) në Prishtinë.

**TETOR, 2006. MUAJI I MUNDËSIVE PROFESIONALE**

**Për personat me aftësi të kufizuara**



**WEB çasje**

**Donatorë:**



**Organizuesi:**



**NGOs PARTNERSHIP OF KOSOVA**



**KONVENTA  
TË DREJTAT E NJERIUT  
PROFESIONE TË REJA**

[www.lpkosova.com](http://www.lpkosova.com)

"Ky projekt u financua përmes grantit të zyrës së SHBA-ve në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit (ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit."